



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
*REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO*

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**

---

Numri i lëndës: 2023:102727  
Datë: 25.03.2024  
Numri i dokumentit: 05495581

PPP.nr.49/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Sami Gashi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit, K.R.U.“Hidroregjioni Jugor” me seli në Prizren, rruga “Wesley Clark” p.n., kundër debitorit, (Sh.M.) përfaqësueses së përkohshme Sh.M., nga Prizreni, rr”.....”, rruga Nashecit, duke vendosur për prapësimin e debitorit, të paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr.1402/2021 të datës 03.11.2021 të lejuar nga përmbartuesi privat Rushit Hoxha me seli në Prizren, jashtë seancës, me datë 25.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I.APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit, Sh.M., nga Prizreni, i paraqitur kundër urdhrit për përmbartim, P.nr.1402/2021 të datës 03.11.2021 të lejuar nga përmbartuesi privat Rushit Hoxha me seli në Prizren, për pjesën e detyrimit në të holla në shumën prej 2.343,34 euro, për periudhën kohore prej 01.02.2008 e deri me datën 31.08.2020, dhe i njëjti Urdhër për përmbartim për këtë pjesë të detyrimit në të holla, Lihet pjesërisht jashtë fuqie.

II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit, Sh.M., nga Prizreni, dhe MBETET NË FUQI pjesa tjetër e urdhrit për përmbartim P.nr.1402/2021 të datës 03.11.2021 të lejuar nga përmbartuesi privat Rushit Hoxha me seli në Prizren, sa i përket detyrimit në shumën prej 108.43 euro, për periudhën kohore prej 09.09.2020 e deri me datën 14.09.2021.

**A r s y e t i m**

Organi përmbartues, përmbartuesi privat, Rushit Hoxha nga Prizreni, duke vendosur sipas propozimit të kreditorit, K.R.U. “.....” me seli në Prizren, ka caktuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.1402/2021 të datës 03.11.2021, duke lejuar propozimin për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm faturës BILL....., dhe kartela financiare e konsumatorit KONS-..... në të cilin e ka urdhëruar debitorin Sh.M., nga Prizreni, që brenda afatit prej 7

ditësh pas pranimit të urdhrin, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 2,451.77 € si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Gjykata me aktvendimin PPP.nr.49/2023 të datës 15.12.2023, e ka caktuar si përfaqësuese të përkohshme Sh.M., nga Prizreni, bashkëshortja e tani të ndjerit Sh.M., nga Prizreni.

Debitori-përfaqësuesja e përkohshme, në afatin ligjor ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar urdhrin e përbaruesit privat, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale nga neni 96 dhe 71 të LPP-së, aplikimin e gabuar të dispozitave materiale (kërkesa e është parashkruar), me propozim që, prapësimi i debitorit të aprovohet i bazuar, urdhri për përbarim i përbaruesit privat të mbetet jashtë fuqie, ndërsa propozimi për përbarim i kreditorit të refuzohet i pa bazuar, tutje ka shtuar se kërkesat e kreditorit janë të parashkruar sipas dispozitave ligjore nga neni 355 të LMD-së.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke i kundërshtuar pretendimet e debitorit si të pa bazuara, pasi që kreditori ka dëshmi kartelën e klientit dhe faturën si dokument i besueshëm, sipas 37 të LPP-së, ku shihet qartë që borxhi total i debitorit ndaj kreditorit është shuma prej 2,451.77 euro, tutje ka shtuar se sa i përket parashkrimit pretendimet e debitorit janë të pabazuara nga arseja që debitori me pagesat e bëra ka pranuar dhe ndërpre parashkrimin, ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar, dhe të detyrohet debitori ta përmbush pagesën e borxhit si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, dhe pretendimet e kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe e duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP, gjeti se, prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret, fatura me nr. BILL00....., dhe kartela financiare e konsumatorit KONS-..... në bazë të cilit është lejuar urdhri për përbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”* ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm i cili i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas

nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në të janë treguar palët, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt, si dhe është përcaktuar shuma e përgjithshme cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, dhe afati për pagesë me datën 11.11.2021.

Gjykata ka vlerësuar dhe marrë për bazë pjesërisht pretendimin e palës debitore të theksuar në prapësim, dhe atë sipas nenit 71 par. 1 pika 4 të LPP-së, në të cilin theksohet që *“prapësimi mund të bazohet vetëm nëse ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbarimi”*, ndërsa sipas nenit 360 par. 1 nën par. 1 të LMD-së, theksohet se *“kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti, kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*. Pra, këto dispozita ligjore parashohin skadimin e afatit kohor për të kërkuar përmbarimin, ndërsa në nenin 369 të LMD-së, thuhet se *parashkrimi nderprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit...*, “, pra kjo dispozitë ligjore parashih ndërprejen e parashkrimit, e në rastin konkret prej periudhës prej 09.09.2020 e deri me datën 14.09.2021 nuk kemi kalim të afatit të parashkrimit, për faktin se debitori me datën 09.09.2020 ka bërë një pagesë në shumën prej 50.00 euro, dhe kreditori me datë 03.11.2021 ka ushtruar propozim për përmbarim, me çka ka ndërpre rrjedhjen e afatit të parashkrimit konform kësaj dispozite për pjesën e detyrimit në të holla në shumën prej 108.43 euro, dhe pala debitore është e obliguar ta përmbushë këtë shumë, ndërsa pala kreditore ka humbur të drejtën e të kërkuarit të përmbushjes së detyrimit në shumën prej 2.343,34 euro, për periudhën kohore prej 01.02.2008 e deri me datën 31.08.2020, sepse kjo pjesë e kërkesës së detyrimit në të holla është parashkruar.

Prandaj nga ajo që u theksua më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 3, 73 par.3 të LPP-së.

## GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr.49/2023

Datë 25.03.2024

Gjyqtari  
Sami Gashi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve, pas ditës së pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate Themelore. Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, nuk e ndalon procedurën e përmbarimit, përveç nëse pala debitore e jep garancinë për shumën e mbetur të kredisë në të holla dhe atë sipas nenit 14, 77 par. 5 dhe nenit 78 të LPP-së.